



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1990/4 prot

Datë 28.09.2022

**V E N D I M**

**Nr. 938/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri  
Fiorent Zguro  
Anila Malaj

Kryetar  
Nënkryetar  
Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.09.2022 me

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “CFO Pharma” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-38370-08-11-2022, me objekt: “Loti 1, Materiale mjekimi të përgjithshëm për nevoja spitalore” me fond limit 8.895.850 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.08.2022 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Shefqet Ndroqi Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:**

Spitali Universitar Shefqet Ndroqi Tiranë  
*Rruga “Shefqet Ndroqi” Sauk, Tiranë*

**Ankimues:**

“CFO Pharma” SHPK.  
*Rruga “Pavarësia”, Nd.1, Tiranë*

**Baza Ligjore:**

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e*

*Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 12.08.2022 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-38370-08-11-2022, me objekt: “Loti 1, Materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore” me fond limit 8.895.850 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.08.2022 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Shefqet Ndroqi Tiranë.

II.2. Në datën 08.09.2022, operatori ekonomik “CFO Pharma” SHPK është njoftuar elektronikisht për vlerësimin dhe klasifikimin e ofertave.

- |   |                              |
|---|------------------------------|
| 1. “CFO Pharma” SHPK                            | 7.999.999 lekë, skualifikuar |
| 2. BOE “Montal” SHPK & “Biometric Albania” SHPK | 8.728.000 lekë, kualifikuar  |

Operatori ekonomik “CFO Pharma” SHPK është skualifikuar me argumentet e mëposhtme:

#### **Arsyet e skualifikimit**

1. Në hapjen e monstrave të “CFO Pharma” ShPK me shkresë të protokolluar në SU “Shefqet Ndroqi” me Nr.138/10 Prot dt.30.08.2022 ora 09:44 u konstatua se dorëzimi i

*mostrave të kërkuara sipas DST-së u bë në 2 kuti. Specifikisht në kutinë e parë u bë dorëzimi i mostrave sipas Pikës 2.3 Kapaciteti Teknik pika b, ndërsa kutia e dytë ishte kuti shoqëruese e kutisë së parë pa asnjë dokument shoqërues. KVO bëri vetëm hapjen e kutisë së parë në të cilën rezultojnë vetëm 4 artikuj si më poshtë : Artikull Nr.5 –Kompresë sterile 10x10 cm -8 PLY, 40's 26x18 – Kompania prodhuese Greetmed Artikull Nr.14 –Doreza kirurgjikale sterile ( ndarë sipas numrave ) – Kompania prodhuese Med's Medical Solutions Artikull Nr.27 –Tub endotrakeal 8.0 -Kompania prodhuese Biçakcilar Artikull Nr.33 –Xhel për ECHO -Kompania prodhuese Aqua Medikal TIBBI Këto artikuj ishin pa listë shoqëruese. KVO pasi bëri vlerësimin e këtyre artikujve rezultoi se artikulli Nr.5 nuk i përmbush specifikimet teknike sipas dokumentacionit të DST-së. Për Artikullin Nr.14; Artikullin Nr.27 dhe për Artikullin Nr.33 nuk përputhet Autorizimi i kompanisë prodhuese të deklaruar nga Operatori Ekonomik në SPE me mostrat e dorëzuara fizikisht. KVO vendosi unanimisht që kutia e dytë e cila ishte shoqëruese e kutisë së parë të mos hapet për verifikim mostrash. 2. Operatori Ekonomik nuk ka plotësuar pikën 2.3 kapaciteti teknik pika " ç " në të cilën thuhet se :Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohe, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. KVO pasi kreu verifikimin e të gjithë katalogëve të ngarkuar në sistemin e SPE vëreu se Katalogët për artikujt si më poshtë mungojnë: Artikulli Nr.3 Bende Adesive 10 cm x 15 m Artikulli Nr.7 Hemostatik kolageni I absorbueshem Artikulli Nr.23 Pleurovac me rregullator tub zgjatës me varse për krevat Artikulli Nr.38 Gojez spirometrike*

II.3. Në datën 14.09.2022, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1990 protokollit e operatorit ekonomik "CFO Pharma" SHPK për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur e thjeshtuar", me Nr. REF-38370-08-11-2022, me objekt: "Loti 1, Materiale mjekimi të përgjithshëm për nevoja spitalore" me fond limit 8.895.850 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.08.2022 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Shefqet Ndroqi Tiranë.

II.4. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1990/2 date 15.09.2022, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik "CFO Pharma" SHPK, për të cilat ngrihen pretendime.

II.5. Në datën 15.09.2022 dhe 16.09.2022 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.6. Me shkresën nr. 138/36 prot, datë 23.09.2022 me objekt: "Dërgim informacioni", protokolluar me tonën me nr. 1990/3 prot datë 26.09.2022, është dërguar pranë Komisionit të

Prokurimit Publik, bashkëngjitur kësaj shkrese, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “CFO Pharma” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të administruar në Komisionin e Prokurimit Publik nga ana e autoritetit kontraktor rezulton, se ankesa është refuzuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Në datën 12.08.2022 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-38370-08-11-2022, me objekt: “Loti 1, Materiale mjekimi të përgjithshëm për nevoja spitalore” me fond limit 8.895.850 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.08.2022 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Shefqet Ndroqi Tiranë..

III.1.1. Referuar materialeve të depozituara në Komisionin e Prokurimit Publik, rezulton se në datën 08.09.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) në procedurën e mësipërme të prokurimit.

- “CFO Pharma” SHPK 7.999.999 lekë, skualifikuar
- BOE “Montal” SHPK & “Biometric Albania” SHPK 8.728.000 lekë, kualifikuar

Njëkohësisht operatori ekonomik “CFO Pharma” SHPK është njoftuar nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (SPE) në lidhje me arsyen e skualifikimit të tij.

#### **Arsyet e skualifikimit**

*1. Në hapjen e mostrave të “CFO Pharma” ShPK me shkresë të protokolluar në SU “Shefqet Ndroqi” me Nr.138/10 Prot dt.30.08.2022 ora 09:44 u konstatua se dorëzimi i mostrave të kërkuara sipas DST-së u bë në 2 kuti. Specifikisht në kutinë e parë u bë dorëzimi i mostrave sipas Pikës 2.3 Kapaciteti Teknik pika b, ndërsa kutia e dytë ishte kuti shoqëruese e kutisë së parë pa asnjë dokument shoqërues. KVO bëri vetëm hapjen e kutisë së parë në të cilën rezultojnë vetëm 4 artikuj si më poshtë : Artikull Nr.5 –Kompresë sterile 10x10 cm -8 PLY, 40’s 26x18 – Kompania prodhuese Greetmed Artikull Nr.14 –Doreza kirurgjikale sterile ( ndarë sipas numrave ) – Kompania prodhuese Med’s Medical Solutions Artikull Nr.27 –Tub endotrakeal 8.0 -Kompania prodhuese Biçakçilar Artikull Nr.33 –Xhel për ECHO -Kompania prodhuese Aqua Medikal TIBBI Këto artikuj ishin pa listë shoqëruese. KVO pasi bëri vlerësimin e këtyre artikujve rezultoi se artikulli Nr.5 nuk i përmbush specifikimet teknike sipas dokumentacionit të DST-së. Për Artikullin Nr.14; Artikullin Nr.27 dhe për Artikullin Nr.33 nuk përputhet Autorizimi i kompanisë prodhuese të deklaruar nga Operatori Ekonomik në SPE me mostrat e dorëzuara fizikisht. KVO vendosi unanimisht që kutia e dytë e cila ishte*

*shoqëruese e kutisë së parë të mos hapet për verifikim mostrash. 2. Operatori Ekonomik nuk ka plotësuar pikën 2.3 kapaciteti teknik pika ” ç ” në të cilën thuhet se :Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. KVO pasi kreu verifikimin e të gjithë katalogëve të ngarkuar në sistemin e SPE vëreu se Katalogët për artikujt si më poshtë mungojnë: Artikulli Nr.3 Bende Adesive 10 cm x 15 m Artikulli Nr.7 Hemostatik kolageni i absorbueshem Artikulli Nr.23 Pleurovac me rregullator tub zgjatës me varse për krevat Artikulli Nr.38 Gojez spirometrike.*

III.1.2. Në datën 14.09.2022, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1990 protokollit e operatorit ekonomik “CFO Pharma” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-38370-08-11-2022, me objekt: “Loti 1, Materiale mjekimi të përgjithshëm për nevoja spitalore” me fond limit 8.895.850 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.08.2022 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Shefqet Ndroqi Tiranë. Referuar materialeve të depozituara në Komisionin e Prokurimit Publik, rezulton se në të njëjtën datë ankimesi ka paraqitur ankesë edhe pranë autoritetit kontraktor.

III.1.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1990/2 date 15.09.2022, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “CFO Pharma” SHPK, për të cilat ngrihen pretendime.

III.1.4. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se në datat 15.09.2022 dhe 16.09.2022 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

III.1.5. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimesim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

*“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen **brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit.***

**Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.**

*7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

*8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati*

*mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*”.

III.1.6. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.*

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

*“1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.*

*2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.*

III.1.7. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, **është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit.**

Në rastin konkret, referuar verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimit Elektronik, rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor është publikuar në datat 15.09.2022 dhe 16.09.2022 njoftimi i fituesit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ndërkohë që operatori ekonomik “CFO Pharma” SHPK ka dorëzuar ankesë për procedurën e mësipërme të prokurimit, pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në datën 14.09.2022. Në këtë ankesë ankimuesi kërkon kualifikimin e tij në procedurën e mësipërme e prokurimit, por nga verifikimi i sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), rezulton, se autoriteti kontraktor ende nuk ka publikuar në sistem njoftimin e fituesit apo njoftimin e anulimit, moment procedural nga i cili fillon afati i ankimit për operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Në rastin konkret referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se:

*“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të*

***ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.***,”

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit (anulimit) dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk ka filluar ende, për sa kohë autoriteti kontraktor nuk ka publikuar njoftimin e fituesit (anulimit) në sistemin e prokurimeve elektronike për procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Në këtë kuptim KPP gjykon, se ankesa e administruar me nr. 1990 protokollin pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dhe në të njëjtën datë e paraqitur edhe pranë autoritetit kontraktor, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*” të ndryshuar parashikohet se:

*“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji”.*

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve është i një rëndësie thelbësore, e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “*Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “CFO Pharma” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-38370-08-11-2022, me objekt: “Loti 1, Materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore” me fond limit 8.895.850 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.08.2022 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Shefqet Ndroqi Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, sipas legjislacionit të prokurimit publik.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiovent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**